
**AKT THEMELIMI & STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“MORE” SHPK**

**AKT THEMELIMI & STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“MORE” SHPK**

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**MORE**” Sh.p.k. qe ketu e tutje do te quhet “shoqeria” dhe zoterohet nga ortakut:

- **Olsi Marku**, atesia Nikolin, shtetas shqiptare lindur me 12/08/1999 ne Shkoder, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, identifikohet nepermjet karte identiteti N. J90812042I;

Në përputhje me vullnetin e tij te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendos të hartojë këtë Akt Themelim & Statut të shoqërisë “**MORE**” Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve.

**KAPITULLI I
EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE,
SELIA, TERRITORI**

**NENI 1
FORMA DHE EMRI**

1.1 Shoqëria ka formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale Sh.p.k., të cilat vijnë përpara ose menjëhere pas emrit të shoqërisë. Kjo shoqëri i përballon humbjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë.

1.2 Emri i shoqërisë është “**MORE**” Sh.p.k. Forma dhe emri i shoqërisë mund të ndryshohen me vendim të Asamblese së Pergjithshme të Ortakëve.

**NENI 2
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, në përputhje me legjislacionin shqiptarë në përgjithsi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marreveshjet ndërkombetare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

**NENI 3
SELIA**

Selia e shoqërisë është në adresën: Rr. Marin Bicikemi N95 / H7, 4001 Shkodër. Me adresën e mësipërme do të identifikohet qendra e personit juridik. Me vendim të

Asamblese së Ortakeve mund të hapen degë, filiale, agjensi ose përfaqësi në Republikën e Shqipërisë sipas fushave në të cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

NENI 4 TERRITORI

4.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj lirisht si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

4.2 Shoqëria mund të krijojë zyra ose përfaqësi të saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Zyrat, filialet ose përfaqësitë e shoqërisë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të zhvillojnë veprimtarine e tyre në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

KAPITULLI II OBJEKTI DHE KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria “**MORE**” Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqërie konsulence ndërmjetësimi pasurish të patundshme dhe ka si objekt të veprimtarisë së saj:

5.1 Dhenia e konsulencës dhe ndërmjetësim pasurish të patundshme ndaj shoqërive, institucioneve publike dhe privatëve, duke bërë studime dhe analiza tregu, perpunim të planeve industriale, kerkimin e partnereve strategjike, ndërmjetësimi, organizimi i takimeve, konferencave dhe gjithçka është e nevojshme me qëllim zhvillimin e shërbimeve.

5.2 Blerja, shitja, shkëmbimi, ndërmjetësimi, rinovimi, menaxhimin dhe dhenia me qira ose nënqira të pasurive të patundshme në përgjithësi.

5.3 Shoqëria mund të zhvillojë çdo tip operacioni tregtare, industrial, të pasurive të patundshme dhe të pasurive të patundshme lidhur me objektin shoqërorë i konsideruar nga organi administrativ i dobishëm për arritjen e objektivave shoqërore.

5.4 Aktiviteti i marketingut strategjik dhe operacional dhe hulumtimit të tregut, aktiviteti i kerkimit dhe zhvillimit.

5.5 Për të arritur këtë objekt, shoqëria mund të përdorë gjithashtu edhe shërbimet e palëve të treta (të punësuar, këshilltarë, anëtarë të tjerë të shoqërisë, profesionistë, përfaqësues, etj.) sipas formave, mënyrave dhe metodave të përcaktuara nga ligji.

5.6 Procesi i përzgjedhjes për rekrutimin e burimeve njerezore dhe organizimin e kurseve të informacionit, edukimit dhe trajnimit profesional edhe në distancë.

5.7 Me qëllim arritjen e objektit të saj, shoqëria me vendim të organit kompetent, mund të zotërojë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, të aktiviteteve të ndryshme.

Pjesëmarrja në shoqëri që për llojin e tyre nuk ofrojnë përgjegjësi të kufizuar, miratohet paraprakisht nga asambleja e ortakeve.

5.8 Promovimi dhe pjesemarrja në mundësi të ndryshme investimi që mund të paraqiten në çdo sektor të ekonomisë së vendit, duke u prezantuar si investitor i barabartë me subjekte të tretë, investitor i vetëm ose investitor mazhoritar me qëllim arritjen e objektivave ekonomike të shoqërisë dhe pjesemarrjes në projektet me impakt social që diktojnë rritjen ekonomike të vendit dhe standartet e tij të jetesës.

NENI 6 KOHEZGJATJA

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat të papërcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedure likuidimi me vendim të Asamblese së Ortakëve, si dhe në rastet e tjera të parashikuara në ligj.

KAPITULLI III KONFIDENCIALITETI, DOKUMENTET E DESTINUARA PËR TË TRETËT

NENI 7 KONFIDENCIALITETI

Ortakët e shoqërisë, administratorët si dhe personat e tjerë të pranuar në shoqëri, bien dakord që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

NENI 8 DOKUMENTET E DESTINUARA PËR TË TRETËT

Të gjithë aktet dhe dokumentet që nxirren nga shoqëria dhe të destinuara për të tretët, si letrat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme etj., duhet të tregojnë lexueshem emrin e shoqërisë dhe pas tij fjalet “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet “Sh.p.k.”, si dhe emrin e administratorit ose të administratorëve.

KAPITULLI IV KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET DHE TRASFERIMI I TYRE

NENI 9 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Leke (njëqindmijë), i ndarë në 1 (një) pjesë. Kapitali themeltar i shoqërisë zotërohet nga:

- Olsi Marku	100 %	- 100.000 LEKE
---------------------	--------------	-----------------------

Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht në një llogari të hapur në emër të shoqërise në bankat e nivelit të dyte.

NENI 10

TE DREJTAT E ORTAKEVE NE LIDHJE ME KAPITALIN

10.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërise kryhet sipas vendimit të asamblese së përgjithshme të ortakeve, me shumicën e $\frac{3}{4}$ (tre të katërtave) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise.

10.2 Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar, i perket ortakeve e drejta me opcion mbi kapitalin ne zmadhim, ne proporcion me kuoten e kapitalit qe kane ne pronesi. Nese ndonjeri nga ortakët nuk do te nenshkruaj kuoten e tij te kapitalit ne zmadhim, e drejta e opcionit do ti perkase ortakeve te tjere.

Duke mos e ushtruar ortakët të drejtën e opcionit, kapitali në zmadhim i panëshkruar do te nënshkruhet nga palë të treta.

10.3 Përgjegjësia e ortakëve për detyrimet e shoqërise shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e saj themeltar.

10.4 Kuotat e kapitalit të shoqërise nuk mund të rendohen lirisht me barrë siguruese apo të drejta të tjera reale. Në rast shitje të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise për efekt zbatimi të një vendimi gjyqësor apo përmbushje të një detyrimi, enti që ekzekuton vendimin ose detyrimin (zyra përmbarrimore ose ndonjë organ tjetër kompetent), duhet të ketë në konsiderate respektimin e kërkesave të nenit 13 të këtij statuti. Secili ortak që rëndon me barrë apo të drejta të tjera reale kuotat e tij, ka detyrimin ti shpjegoje neni 13 të këtij statuti subjektit në favor të cilit vendoset barra siguruese.

10.5 Secili ortak ushtron të drejtat pasurore të parashikuara nga ligji në proporcion me kuotat e pjesëmarrjes ne kapital.

10.6 Ortakët që nuk marrin pjesë në administrimin e shoqërise kanë të drejtë t'i kërkojnë organit administrativ informacione mbi aktivitetin e shoqërise, si dhe të konsultojne dokumentet kontabel e dokumentet e tjera që lidhen me administrimin.

NENI 11

FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKUT

Fusha e autoritetit të ortakëve, përqindja e fitimeve ose humbjeve do te kene si kriter bazë kontributin e çdo ortaku në kapitalin e shoqërise, si dhe kompetencat që gezon ortaku në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuar në këtë statut.

NENI 12

FINANCIMI I SHOQERISE

12.1 Organi administrativ, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ka të drejtë të kërkoje nga ortakët fondet e nevojshme për arritjen e objektit të shoqërise.

12.2 Financimet e mëtejshme të ortakëve do të jene me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit jepen këto fonde.

NENI 13

TRASFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

13.1 Kapitali themeltar i shoqërise ose pjesë të tij mund të transferohen lirisht mes ortakëve të shoqërise. Kapitali themeltar i shoqërise ose pjesë të tij mund të transferohen tek persona të tretë vetëm pasi ortakët e shoqërise në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar zyrtarisht kanë refuzuar ushtrimin e të drejtës së parablerjes.

13.2 Transferimi i kapitalit themeltar të shoqërise ose i pjesëve të tij tek persona të tretë bëhet vetëm në këtë mënyrë:

- Oferta për shitje u drejtohet të gjithë ortakëve me shkrim;
- Oferta duhet të përcaktojë numrin e kuotave që shiten dhe çmimin e tyre;

Nëse ortakët e shoqërise brenda 3 (tre) muaj nga oferta me shkrim nuk pranojnë blerjen e kuotave të ofruara me çmimin e përcaktuar, atëherë konsiderohet se ata lejojnë shitblerjen tek të tretët.

13.3 Kapitali themeltar është lirisht i trashëgueshem në rrugë trashigimie. Bashkshorti, paraardhësit dhe pasardhësit mund të bëhen ortakë nëpërmjet transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar sipas kushteve që lejohen në ligj.

13.4 Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohen me akt noterial dhe të depozitohen në organin kompetent.

13.5 Klausolë miratimi. Nëse asnjë ortak nuk do të ushtrojë të drejtën e parablerjes në kohë dhe sipas kushteve të parashikuar për transferimin e kuotave apo të drejtën e opcionit, kalimi i kuotave nuk do të mund të bëhet pa pëlqimin e Asamblese së Ortakëve që vendos për pranimin e transferimit të një personi të tretë.

Ortakët mbledhen jo më herët se 30 (tridhjetë) ditë, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë, nëpërmjet Asamblese të Zakonshme të Ortakëve, duke vendosur me votën pro (në favor) me të paktën gjysmën e kapitalit themeltar.

13.6 Pëlqimi mund të refuzohet vetëm kur blerësi nuk jep garanci të mjaftueshme rreth kapaciteteve financiare ose për kushtet objektive o për aktivitetin që kryen, të tilla që hyrja e tij në shoqëri mund të jetë e dëmshme për arritjen e objektivave nga shoqëria ose konflikt me interesat e shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

Asambleja e Ortakëve duhet të njoftojë me shkrim në adresën që rezulton vendimin për miratim.

Nëse brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës për miratim ortaku kërkues që nuk ka marrë asnjë komunikim miratimi do të konsiderohet si i dhënë dhe mund të transferojë kuotën e tij.

13.7 Nëse miratimi i mohohet do të prezantohet një tjetër blerës. Për këtë qëllim, Asambleja e Ortakëve duhet të pasqyrojë në letrën e refuzimit emrin e blerësit të propozuar. Transferimi duhet të plotësohet me të njëjtat kushte të përcaktuara në kërkesën për miratim nga ana e aplikantit brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve pas marrjes së komunikimit të fundit. Përndryshe, ortaku do të jetë i lire për të shitur pjesëmarrjen e tij personit që konsideron me të përshtatshëm.

KAPITULLI V **ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

NENI 14 **ORGANET DREJTUESE**

14.1 Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Ortakëve dhe Administratori. Për efekt të ndryshimeve që mund të pësoje shoqëria në të ardhmen dhe shtimit të numrit të ortakëve, këtu e në vazhdim organit zotërues të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise do ti referohemi me termin Asambleja e Ortakëve.

14.2 Shoqëria mund të emërojë më shumë se një Administrator. Ne çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar Administratorin e shoqërise “**MORE**” Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë Administratorët e saj sado qofshin këta në numer.

14.3 Përveç organeve të parashikuara me sipër Asambleja e Ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, ne aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre.

14.4 Administrator i shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare është emëruar ortaku **Olsi Marku**.

KAPITULLI VI **ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

NENI 15 **VENDIMET E ASAMBLESE TE ORTAKEVE**

15.1 Asambleja e Ortakeve vendos për çështjet që ligji apo ky Statut i rezervon këtij organi, si dhe për çështjet për të cilat, organi administrativ kërkon mendimin apo miratimin e ortakëve.

15.2 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Ortakeve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50 % të kuotave të kapitalit themeltar.

Në rastin kur Asambleja e Ortakeve duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas ligjit mbi shoqëritë tregtare, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 75 % të numrit total të kuotave të kapitalit themeltar janë të pranishëm dhe vendosin me votën e $\frac{3}{4}$ (tre të katertave).

NENI 16 **KONSULTIMI ME SHKRIM I ORTAKEVE**

16.1 Në përputhje me dispozitat e statutit, vendimet e ortakëve mund të merren pas një konsultimi me shkrim që organi administrativ i drejton secilit prej tyre. Në këtë rast,

organi administrativ i komunikon ortakeve tekstin e projekt-vendimit qe do te merret dhe i kerkon te shprehin vullnetin e tyre ne lidhje me kete çeshtje.

16.2 Vendimet e marra ne kete menyre jane te vlefshme kur vendimi merret nga shumica qe ligji apo ky Statut kerkon per ate çeshtje.

NENI 17

MENYRA DHE VENDI I THIRRJES

I ASAMBLESE SE ORTAKEVE

17.1 Asambeja e Ortakeve thirret prane selise se shoqerise, apo ne ndonje vend tjetër brenda ose jashte Republikes se Shqiperise, edhe përmes modalitetit online, nepermjet nje njoftimi me shkrim nepermjet postes elektronike (E-mail), qe iu dergohet ortakeve nga Kryetari i Asamblese se Ortakeve dhe / ose Organi Administrativ.

17.2 Njoftimi i thirrjes se mbledhjes se asamblese duhet te kryhet 15 (pesembedhete) dite perpara dates se mbledhjes dhe duhet te percaktoje shprehimisht daten, oren, vendin si dhe rendin e dites. Ne rast pamundesie apo mosveprimi nga ana e organit administrativ, mbledhja e asamblese se ortakeve mund te thirret nga esperti kontabel i autorizuar, nese ka te tille, ose nga nje apo me shume ortake, te cilet perfaqesojne jo me pak se 10% te kapitalit te shoqerise.

NENI 18

KRYETARI I ASAMBLESE SE ORTAKEVE

18.1 Mbledhja e Asamblese se Ortakeve emeron Kryetarin e Asamblese.

18.2 Kryetari i Asamblese verifikon thirrjen dhe mbledhjen e rregullt te Asamblese se Ortakeve, verteton identitetin apo legjitimimin e perfaqesuesit te ortakeve dhe drejton zhvillimin e rregullt te mbledhjes.

NENI 19

PJESEMARRJA NE VENDIME

Çdo ortak ka te drejten e nje vote per çdo kuote te kapitalit themeltar te shoqerise qe ai zoteron. Nje ortak mund te perfaqesohet ne mbledhjen e asamblese nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete, nepermjet nje akti perfaqesimi me shkrim.

NENI 20

KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

20.1 Asambleja e Ortakeve mund te jete e zakonshme dhe e jashtezakonshme, kjo ne varesi te çeshtjes per te cilen eshte thirrur. Vendimet e Asamblese se Zakonshme te Ortakeve merren me shumice te thjeshte te votave te ortakeve. Vendimet e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve merren me nje shumice te cilesuar prej $\frac{3}{4}$ (tre te katertave) te votave te ortakeve te shoqerise. Per çfare nuk eshte pasqyruar ne kete nene, Asambleja e Ortakeve te shoqerise vendos ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14. 04. 2008.

20.2 Kompetencat e Asamblese se Zakonshme te Ortakeve do te jene:

- Vendos per perpilimin ose miratimin e rregulloreve per shoqerine.

- Vendos per ndryshimin e selise se shoqerise.
 - Vendos per krijimin e zyrave ose te perfaqesive si dhe per krijimin e shoqerive ose te ortakerive me persona te tjere fizike apo juridike.
 - Vendos per politiken afariste te shoqerise dhe percakton fushat konkrete te veprimtarise se saj.
 - Emeron dhe shkarkon Administratorin e shoqerise, ekspertin kontabel, likujdatorin duke percaktuar dhe detajuar kompetencat e tyre, te drejtat, detyrimet, kohezgjatjen ne detyre, dhe shperblimin e tyre.
 - Vendos ne lidhje me krijimin e organeve te tjera drejtuese qe mund t'i nevojiten shoqerise duke percaktuar ne aktet e krijimit te ketyre organeve, kohezgjatjen dhe kompetencat e tyre, per emerimin e personave drejtues te ketyre organeve.
 - Asambleja e Ortakeve marrjen e vendimeve e kryen vete dhe nuk ben delegimin e vendimarrjes te asnje organ tjetër. Asambleja e Ortakeve vendos edhe ne lidhje me krijimin e sektoreve te veçante te veprimtarise se shoqerise.
 - Shqyrton dhe miraton bilancin vjetor.
 - Miraton tarifat e sherbimeve te shoqerise dhe pagat e te punesuarve ne shoqeri.
- 20.3** Kompetencat e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve jane:
- Vendos ne lidhje me zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
 - Vendos ne lidhje me kohezgjatjen e shoqerise si dhe per mbarimin e likujdimin e saj.
 - Vendos ne lidhje me ndryshimin e statutit dhe ndryshimin e emrit te shoqerise.
 - Vendos per ndryshimin e formes, per ndarjen e shoqerise si dhe per bashkimin e saj me shoqeri te tjera.
 - Percakton llojin e fondeve te ndryshme dhe masen e tyre, percaktimin e dividetit, marrjen dhe dhenien e huave, kredive, borxheve.
 - Realizon marredheniet me te rendesishme ekonomike dhe financiare te shoqerise me persona te tjere fizik apo juridik, vendas apo te huaj.
 - Vendos ne lidhje me transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise.

20.4 Perveç kompetencave te lartpermendura, te cilat jane ekskluzive per te, Asambleja e Ortakeve ushtron çdo kompetence qe ia njeh ligji.

20.5 Asambleja e Ortakeve ne rastet kur nuk ka emeruar Administrator, kryen dhe kompetencat qe ne kete Statut jane percaktuar per kete te fundit. Gjithashtu Asambleja e Ortakeve mund te kufizojë Administratorin ne ushtrimin e kompetencave te tij.

NENI 21

ADMINISTRATORET DHE KOMPETENCAT E TYRE

21.1 Kompetencat e Administratorit ose te Administratoreve, te cilet mund edhe te mos jene ortake te shoqerise, ne menyre konkrete dhe te detajuar percaktohen ne aktin e tyre te emerimit. Veç te tjerave qe mund te detajohen ne kete akt, Administratori ka edhe keto kompetenca:

- Kujdeset per funksionimin e perditshem normal te shoqerise ose te nje pjese te aktivitetit ekonomik dhe financiar te saj, sipas percaktimit ne aktin e emerimit.
- Pergatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme per gjendjen ekonomike dhe financiare te shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ia paraqet Asamblese se Ortakeve per shqyrtim.
- Koordinon veprimtarine e personave te punesuar ne shoqeri.
- Ndjek problemet e shoqerise ne marredhenie me organet shteterore ose cakton ndonje prej personelit per trajtimin e ketyre problemeve.
- I propozon Asamblese se Ortakeve tarifat e sherbimeve dhe pagat per personelin e punesuar ne shoqeri.
- I propozon Asamblese se Ortakeve rregulloren e shoqerise.
- Administratoret kane te drejte te gjithë sebashku ose veçmas nga njeri tjetri te perfaqesojne shoqerine ne lidhje me te tretet.

21.2 Administratori ose Administratoret jane pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve qofte per shkelje ligjore, qofte per shkelje te statutit ose per faje te kryera gjate ushtrimit te administrimit te shoqerise. Pergjegjesia eshte individuale ose solidare, kjo ne varesi te rrethanave dhe te menyres se si eshte vepruar, pra individualisht ose solidarisht.

21.3 Administratori ose Administratoret nuk jane pergjegjes ndaj shoqerise ose te treteve per konfliktin e interesit qe mund te krijohet duke zhvilluar pozicione te ndryshme ose te ngjashme ne shoqeri dhe organizma te ndryshem, edhe nga cfare parashikohet ne neni 7 i ketij statuti.

21.4 Shoqeria mund te administrohet nga nje administrator i vetem ose nga shume administratore, nga dy deri ne nente anetar, sipas krijimit nga akti i emerimit. Ne rastin e shume administratoreve, ata mund te formojne nje trup kolektiv, keshilli i administrimit, ose nje trup jo kolektiv, anetaret e te cilit mund te veprojne bashkerisht, te ndara, ose te miksuara ne baze te asaj qe do te krijohet nga akti i emertimit.

21.5 Nuk mund te emertohet administrator ose perfaqesues dhe, nese emertohet, bie nga zyra e tij, ndalohet, i paafti, deshtuesi ose kush eshte denuar me nje denim, edhe perkohesisht, nga zyrat publike ose paaftesia ne ushtrimin e zyrave ekzekutive.

21.6 Administratoret kane te gjithë kompetencat e drejtimit te zakonshem te shoqerise per zbatimin e qellimit te saj, pervec kompetences se dhene nga vendimi i ortakeve ne perputhje me ligjin. Cdo administrator ose perfaqesues mund te heqi dore ne cdo moment, duke derguar nje njoftim me poste rekomande ose nepermjet nje njoftimi me shkrim nepermjet postes elektronike (E-mail) tek administratoret e tjere, ne rastin e shume administratoreve, dhe cdo ortakeve. Doreheqja ka efekt te menjehershëm nese mbetet ne detyre shumica e administratoreve ose perfaqesuesve. Ne rast te kundert, ajo ka efekt nga momenti qe emerohet administratori ose perfaqesuesi i ri, vetem nese, te mbetet te pakten nje administrator ose perfaqesues, doreheqja do te pranohet me shkrim nga ana e cdo ortaku tjetër, ne kete rast, komunikimi i administratorit qe jep doreheqjen nderpritet menjehere.

21.7 Cdo administrator ose perfaqesues pushohet nga detyra per skadencen e afatit te themeluar nga akti i emertimit, ne vdekje, per paraqitjen e situatave qe sjellin padrejtesi ose papajtueshmeri per detyren, qoft kjo edhe pa shkak, me vendim te ortakeve. Ne kete rast, nderprerja e kontrates verifikohet kur vendimi per terheqje, i eshte njoftuar nepermjet postes ose me dore administratorit ose perfaqesuesit te revokuar. Revokimi, ne mungese te nje shkak, nuk sjell asnje te drejte per te kompesuar demet.

21.8 Keshilli i Administrimit. Keshill administrimit perbehet nga nje numer anetaresh i vendosur nga akti i emertimit, nga te cilet eshte zgjedhur presidenti dhe zevendes presidenti, nese nuk eshte bere nga vendimi i ortakeve. Keshilli i administrimit, mbledh si ne zyren qendore ashtu edhe tjeterkund, sa here e gjykon te nevojshme, te pakten nje keshilltar ose, nese eshte emeruar, kryetari i komunes ose auditori. Procedura ne mbledhjet e keshillit mund edhe te behet nepermjet mjeteve te telekomunikimit, me kushtin qe te gjithe pjesemarresit mund te identifikohen dhe ti lejohet qe te ndjekin diskutimet, te marrin, te transmetojne ose te shohin dokumente, te nderhyjne duke folur ne kohe reale mbi te gjitha argumentet. Per vlefshmerine e vendimeve te keshillit duhet te jene te pranishem dhe me vota te favorshme nga shumica e anetareve.

Vendimet e administratorit mund edhe te jene te miratuara nga konsultimet me shkrim, ose pelqimin e shprehur me shkrim te derguara me telegram, telefaks ose e-mail brenda periudhes se specifikuar ne kerkese. Ne kete rast aplikohen te gjitha dispozitat e diktuar lidhur me vendimet e ortakeve nga paktet sociale prezente. Brenda kufijve ligjore, keshilli i administrimit mund te delegoje fuqine e tij, te gjithen ose nje pjese, tek nje ose disa anetareve te tij.

KAPITULLI VII **KONTROLI KONTABEL,** **BILANCI, DIVIDENTET**

NENI 22 **KONTROLI KONTABEL**

Kontrolli i jashtem kontabel i shoqerise kryhet nga eksperte kontabel te autorizuar, sipas legjislacionit ne fuqi. Asambleja e Ortakeve do te emeruje nje apo me shume eksperte kontabel ne ato raste kur emerimi i tyre konsiderohet i nevojshem ose kerkohet ne baze te ligjit.

NENI 23 **BILANCI DHE REZERVAT**

23.1 Bilanci mbyllet ne 31 dhjetor te çdo viti. Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiare dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel i autorizuar, i paraqiten per shqyrtim asamblese se ortakeve, e cila vendos mbi miratimin,

ndryshimin ose rrezimin e ketyre akteve, kur e konsideron te nevojshme Asambleja e Ortakeve mund te beje rekomandimet e nevojshme ne lidhje me çeshtjen ne diskutim.

23.2 Me mbylljen e secilit vit financiar, Administratori i vetem merr masat e nevojshme per hartimin e projekt-bilancit te aktivitetit per vitin financiar te mbyllur, ne menyre qe Asambleja e Ortakeve te vendose mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme te tij brenda afateve te percaktuara nga ligji.

23.3 Asambleja e Ortakeve vendos mbi ndarjen ndermjet ortakeve te shumave qe rezultojne si fitime sipas bilancit te aprovuar rregullisht, pasi nga keto shuma te jene zbritur humbjet e mundshme te viteve te meparshme, si dhe te jene lene menjane shumate e nevojshme per krijimin e rezerves ligjore. Rezerva ligjore krijohet vit pas viti nepermjet lenies menjane te nje shume te barabarte me 5 % te fitimit neto te realizuar gjate secilit vit financiar, deri sa te arrihet nje shume e barabarte me 10 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

23.4 Asambleja e Ortakeve ne çdo moment mund te vendose krijimin e rezervave te tjera, si dhe masen e tyre.

KAPITULLI VIII **MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE,** **LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE**

NENI 24 **MBARIMI**

Shoqeria mbaron me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve ose kur ka nje prishje te parakohshme per arsytet e parashikuara ne ligj.

NENI 25 **LIKUJDIMI**

25.1 Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi Asambleja e Ortakeve cakton nje ose disa likujdues, te cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetin te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

25.2 Ne fund te procesit te likujdimit, Asambleja e Ortakeve vendos mbi bilancin perfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit te likujdimit.

25.3 Mbas pagimit te kreditoreve Asambleja e Ortakeve mban pjesen e mbetur te kapitalit qe u shperndahet ortakeve.

NENI 26 **LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE**

26.1 E drejta e largimit lejohet në rastet e parashikuara me ligj.

Njoftimi i largimit duhet ti dërgohen shoqërisë me shkrim dhe duhet të përfshijë emër mbiemër të ortakut që largohet, vendbanimin, për komunikimet e nevojshme mbi

procedurën e largimit dhe numrin e kuotave në lidhje me të cilat synon të largohet motivimet përkatëse.

Ortakët që largohen nga shoqëria kanë të drejtë të marrin një rimbursim të kuotave në proporcion të kapitalit të shoqërisë. Për këtë qëllim është përcaktuar duke marrë parasysh vlerën e tij të llogaritur në bazë të kapitalit neto.

26.2 Shlyerja e kuotave për të cilën është ushtruar e drejta e largimit duhet të bëhet brenda 90 (nentedhete) ditëve nga komunikimi që i bëhet shoqërisë. Ajo gjithashtu mund të bëhet me anë të blerjes nga ortakët e tjerë në proporcion me pjesëmarrjen e tyre ose nga një palë e tretë të identifikuar në mënyrë unanime nga ortakët.

Për këtë qëllim, administratorit i kërkohet që të njoftojë ortakët e tjerë mbi mbarëvajtjen e procedurës së largimit të ortakut, dhe t'ia ofrojë për shitje, në emër dhe për llogari të ortakut që largohet, pjesën mbi të cilën është ushtruar largimi, duke deklaruar çmimin e kuotes dhe afatin për pagesën e saj, jo më shumë se 3 (tre) muaj. Për shitjen zbatohen rregulla mbi ushtrimin e së drejtës të parablerjes në këtë Statut.

26.3 Ortakët duhet të informojnë shoqërinë për qëllimin e tyre për të blerë kuotat e ortakut që largohet ose emrin e palës së tretë blerëse brenda 30 (tridhete) ditëve nga marrja e komunikimit nga shoqëria dhe qëllimin e ortakut për t'u larguar. Nëse oferta është pranuar nga shumica e ortakëve, pjesa e ortakut që largohet do të ndahet në proporcion midis ortakëve në baze të kuotave që kanë në kapitalin themeltar.

Nëse kjo nuk ndodh, rimbursimi do të bëhet duke përdorur rezervat e disponueshme ose në mungesë përkatësisht zvogëlimin e kapitalit; nëse nuk është e mundur një rimbursim i kuotave të ortakut që largohet, atëherë shoqëria vendoset në likuidim.

26.4 Përjashtimi i ortakut mund të bëhet, në rast të vonesës apo pamundësisë së kryerjes të punës ose shërbimeve që mund të kryhen nga një ortakë.

Përjashtimi duhet të përcaktohet me vendim të Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve me tre të katërtat e votave.

Pas zbulimit të vendimit për të përjashtuar ortakun, ky i fundit është i penguar për të ushtruar të drejtat shoqërore.

26.5 Për likuidimin e kuotës të ortakut që largohet, aplikohet procedura e rimbursimit e parashikuar për largimin, përjashtuar këtu mundësia e shlyerjes së kuotës nëpërmjet reduktimit të kapitalit themeltar dhe likuidimin e mundshëm të shoqërisë.

Përjashtimi mund të revokohet, derisa kuota e ortakut të përjashtuar nuk i është rimborsuar.

KAPITULLI IX

MOSMARREVESHJET DHE DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 27

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Çdo mosmarreshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do të angazhohen se do ta

zgjidhin me mirekuptim, dhe ne rast se kjo nuk arrihet kompetente per gjykimin e mosmarreshjeve a konflikteve te mundshme do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor.

NENI 28
DISPOZITA TE FUNDIT

28.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Statuti dhe me ligjin shqiptare. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete akt, do te aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptare ne fushen e shoqerive tregtare si dhe legjislacioni shqiptare ne pergjithsi.

28.2 Shoqeria do te kete vulen, stemen, logon dhe faqen e internetit (website), format dhe madhesite do te percaktohen nga asambleja e ortakeve ne vecanti dhe me propozim te administratorit.

28.3 Ky Statut eshte hartuar ne 3 (tre) ekzemplare ne gjuhen shqipe, duke patur secili ekzemplare fuqi te njejte ligjore.

Shkoder 23/04 / 2024

ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE
"MORE" SHPK

Olsi Marku

Olsi Marku
